



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.05.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe “**, Nr. i prokurimit- 632-24-2484-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-032-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik " N.SH.T. VIKTORY COM, e dt.15.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe “, Nr. i prokurimit- 632-24-2484-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-032-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.05.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.15.05.2024, Operatori ekonomik " N.SH.T. VIKTORY COM, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **“Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe “**, Nr. i prokurimit- 632-24-2484-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-032-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse dokumentet që ju pretendoni se është dashur Autoriteti kontraktues të ju kërkoj në bazë të nenit 72 të LPP-së, janë dokumente që mund të prodhohen. Marrëveshja për furnizim me asfalt, e prezentuar nga ju, ka edhe një problem sepse tek noterizimi ka mospërputhje të datave – marrëveshja është e lidhur me dt. 12.04.2024, kurse ju jeni paraqitur te noteri(keni noterizuar) marrëveshjen me dt. 11.04.2024, pra noterizimi është bërë një ditë para lidhjes së marrëveshjes.

Me këtë është konfirmuar pretendimi ynë se ky dokument nuk duhet të kërkohet.

Pretendimi juaj i dytë lidhur me finisherin, gjithashtu është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues në kërkesën e tij në FDT-ë, nuk ka caktuar se çfarë peshe duhet të ketë finisheri, por vetëm është kërkuar finisher, të cilën kërkesë e ka plotësuar Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë..

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës